

Marija Risteska, PhD.
Ljupka Trajanovska, M.Sc.

DORACAK PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT TË RREGULLATIVËS MBI BARAZINË GJINORE

Përmbajtje

Fjalorth.....	4
Qëllimi i doracakut.....	5
Për kë dedikohet ky doracak?	5
Hyrje.....	6
Çfarë është barazia gjinore?.....	7
Parimet dhe rëndësia e arritjes së barazisë gjinore	8
Çfarë është përfshirja e aspekteve gjinore në politikat kryesore ose ‘gender mainstreaming’? ..	9
Korniza ligjore për barazinë gjinore	11
Rregullativat	13
Çfarë është vlerësimi i ndikimit të rregullator/të politikave?.....	14
Vlerësimi i ndikimit rregullator në Republikën e Maqedonisë së Veriut	15
Vlerësimi i ndikimit rregullator mbi barazinë gjinore	16
Hapi 1. Përkufizimi i problemit.....	17
Hapi 2. Përkufizimi i qëllimeve	18
Hapi 3. Identifikimi i opsioneve për politika publike.....	19
Hapi 4. Vlerësimi i ndikimit dhe përzgjedhja e opsionit më të mirë.....	20
Hapi 4.1. Konsultimet	21
Hapi 4.2 Implikimet fiskale	21
Hapi 4.3. Zgjedhja e opsionit më të mirë	21
Hapi 5. Monitorimi dhe vlerësimi	22
Doracak për vlerësimin e ndikimit rregullator mbi barazinë gjinore	22

Fjalorth

SEKSI - i referohet karakteristikave biologjike dhe fiziologjike që përkufizojnë burrat dhe gratë, respektivisht numrin dhe llojin e kromozomeve seksuale, hormonet, anatominë e brendshme riprodhuese dhe organet gjenitale të jashtme. Këto karakteristika janë universale dhe, në përgjithësi, të përhershme. Përshtatim bëjnë rastet e personave interseks në të cilët, që nga lindja, këto karakteristika nuk janë as plotësisht tipike mashkullore dhe as plotësisht tipike femërore.

GJINIA - përdoret për të përshkruar të gjitha karakteristikat e dhëna shoqërore, rolet, aktivitetet dhe përgjegjësitë e caktuara që lidhen me atë që do të thotë të jesh burrë (man) apo grua (woman) në një shoqëri të caktuar. Vajzat dhe djemtë nuk lindin duke ditur se si duhet të vishen, të flasën, të mendojnë apo të reagojnë. Gjinia manifestohet përmes sjelljeve të mësuara nga shoqëria dhe pritshmërive që lidhen me të dy seksin, përmes kulturës, traditës dhe asaj që një shoqëri e caktuar e konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat (rolet e ndërtruara nga shoqëria). Këto janë thjeshtë “norma” sociale dhe mund të ndryshohen.

ROLET GJINORE - përkufizohen si norma apo bindje në një shoqëri/komunitet apo grup tjetër të veçantë, të cilat kushtëzojnë se cilat aktivitete, detyra dhe përgjegjësi perceptohen si mashkullore apo femërore. Rolet gjinore ndikohen nga moshë, klasa, raca, përkatësia etnike dhe fetare, si dhe mjediset gjeografike, ekonomike dhe politike. Ndryshimet në rolet gjinore shpesh ndodhin si përgjigje ndaj ndryshimeve në rrethanat ekonomike, natyrore ose politike, duke përfshirë përpjekjet e përgjithshme për zhvillim në shoqëri.

BARAZIA GJINORE - është një koncept që do të thotë se si burrat ashtu edhe gratë janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa kufizime të imponuara nga stereotipet, rolet e ngurta gjinore ose paragjykimet. Barazia gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë, por kjo nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur si meshkuj apo femra. Barazia gjinore është një proces i drejtësisë dhe barazisë në shpërndarjen e resurseve, mundësive dhe përfitimeve për gratë/vajzat në raport me burrat/djemtë dhe anasjelltas. Barazia lind nga njohja se për arsye historike dhe strukturore, grupe të caktuara përballen me rrethana të pavolitshme dhe për këtë arsye duhet të merren masa kontekstuale për të siguruar që pozita e tyre e pavolitshme të mos jetë e përhershme.

PARITETI GJINOR - shkon përtej fokusit në trajtimin e barabartë dhe bazohet në rëndësinë e rezultateve. Pariteti gjinor arrihet duke i trajtuar grupet në mënyrë të ndryshme, për t'i dhënë fund pabarazisë dhe nënkupton që gratë dhe burrat gëzojnë të njëjtin status. Pariteti gjinor nënkupton që gratë dhe burrat kanë kushte (të barabarta) për realizimin e plotë të të drejtave të tyre të njeriut dhe potencialin për të kontribuar në zhvillimin kombëtar, politik, ekonomik, social dhe kulturor dhe për të përfituar nga zhvillimi.

FUQIZIMI I GRAVE - përfaqëson aftësinë e një gruaje për të kontrolluar dhe menaxhuar fatin, jetën dhe të ardhmen e saj. Për këtë nevojiten: aftësi të barabarta, qasje të barabartë në resurse dhe mundësi, mundësi për udhëheqje dhe pjesëmarrje në institucione politike - mundësi për të përdorur të drejtat, aftësitë, resurset dhe mundësitë për të vendosur dhe për të marrë vendime si dhe rrethinë/mjedis në të cilën nuk ka shtrëngim dhe frikë.

VETËDIJËSIMI GJINOR - është të kuptuarit se ekzistojnë dallime të përcaktuara shoqërore midis grave dhe burrave që bazohen në sjelljen e mësuar. Kjo ndikon në aftësinë e tyre për qasje në resurse dhe për t'i kontrolluar ato. Ky vetëdijësim duhet të realizohet përmes analizës gjinore në projekte, programe dhe politika.

NDJESHMËRIA GJINORE - shoqëron aftësinë për të njohur dhe nxjerrë në pah dallimet, çështjet dhe barazitë ekzistuese gjinore dhe për t'i përfshirë ato në strategji dhe veprime. Ndjeshmëria gjinore nuk do të thotë që ne nuk i njohim më dallimet midis burrave dhe grave. Përkundrazi, ndjeshmëria gjinore, në veçanti, manifestohet në njohjen e dallimeve që rrjedhin nga privilegjet dhe diskriminimi i burrave dhe grave.

INTEGRIMI GJINOR - është procesi i bërjes së një vlerësimi të ndikimit të çdo aktiviteti të planifikuar (duke përfshirë legjislacionin, politikat ose programet) mbi gratë dhe burrat në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet. Qëllimi përfundimtar është arritja e barazisë gjinore.

PERSPEKTIVA GJINORE është përfshirja e perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore, politikat dhe praktikën, nënkupton (ri)organizimin, përmirësimin, zhvillimin dhe vlerësimin e politikave, strategjive dhe programeve të përgjithshme në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat nga aktorët e përfshirë në krijimin e politikave. Kjo do të thotë një përpjekje për të ngritur në nivel politik detyrimin e shtetit për të kapërcyer matricën tradicionale patriarkale të rregullimit të marrëdhënieve midis burrave dhe grave si një pengesë reale për arritjen **de facto** të barazisë.

Qëllimi i doracakut

Ky doracak ofron informacione dhe është një mjet praktik për vlerësimin e ndikimit rregullator në nivel qendror dhe do të lehtësojë procesin e përfshirjes së perspektivës gjinore në vendimet e marra në nivel qendror.

Doracaku ofron informacione bazë dhe udhëzime praktike se si të vlerësohet ndikimi rregullator/ i një vendimi të miratuar në nivel qendror mbi barazinë gjinore. Doracaku synon të shpjegojë në mënyrë të thjeshtë procedurën dhe hapat në realizimin e vlerësimit të ndikimit rregullator mbi barazinë gjinore. Metodologjia dhe “mjetet” praktike të paraqitura në këtë doracak mund të zbatohen edhe për grupe të tjera të rrezikuara të shoqërisë, siç janë: personat me aftësi të kufizuara, grupet e pakicave etj.

Për kë dedikohet ky doracak?

Doracaku është i dedikuar për nëpunësit shtetërorë që punojnë në ministritë dhe organet e tjera të administratës shtetërore, si dhe subjektet që u janë besuar autorizime publike, dhe para së gjithash:

- ✓ Për të gjithë të punësuarit në administratën shtetërore që punojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave në nivel qendror dhe lokal, për të siguruar ndjeshmërinë gjinore, mirëkuptimin dhe gatishmërinë e nevojshme për integrimin e plotë të perspektivës gjinore në rregullativat ligjore dhe vendimet e Qeverisë dhe vetëqeverisjes lokale.
- ✓ Për të gjithë të punësuarit në nivel qendror dhe lokal, për të siguruar ndjeshmërinë gjinore, mirëkuptimin dhe gatishmërinë e nevojshme për integrimin e plotë të perspektivës gjinore në planifikimin dhe krijimin e shërbimeve të ofruara nga Qeveria dhe vetëqeverisja lokale, me ç'rast do të sigurohet një efekt konkret në avancimin e pozitës së grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe publike.
- ✓ Doracaku mund të shërbejë si një mjet i dobishëm për aktorët tjerë në shoqëri të cilët punojnë në fushën e vendosjes dhe përforcimit të barazisë gjinore, siç janë organizatat e shoqërisë civile, dhomat dhe grupet e tjera të interesit.

Hyrje

Raporti i Bashkimit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga viti 2021, theksoi përparimin e vendit në aspekt të kornizës ligjore për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe thekson se ai është në masë të madhe në përputhje me standardet evropiane. *“Progres i rëndësishëm është arritur me miratimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, me mbështetje ndërpartiake. Përmirësim është vërejtur në drejtim të përfshirjes të aspekteve gjinore në politikat dhe të drejtat kryesore të grave, edhe pse gratë janë ndër kategoritë më të goditura nga pandemia”*¹. Komisioni Evropian theksoi se është arritur një përparim i caktuar në aspektin e barazisë gjinore me harmonizimin plotësues me Konventën e Stambollit dhe theksoi se është i nevojshëm harmonizimi i ligjeve përkatëse, miratimi i akteve nënligjore dhe procedurave operative. Që nga fillimi i pandemisë me KOVID-19 në vitin 2020 dhe vazhdimi i saj në vitin 2021, ka pasur një regres domethënës në të drejtat, mundësitë dhe sigurinë e grave dhe vajzave². Aspirata e përgjithshme për të fuqizuar gratë për pjesëmarrje të barabartë në proceset ekonomike, shoqërore dhe politike, për role të barabarta të grave dhe burrave në familje, në ekonominë familjare dhe në shoqëri, janë zvogëluar gjatë krizës, dhe ndikimet negative tek gratë pritet të ndjehen edhe më shumë gjatë periudhës së rimëkëmbjes.

Indeksi i hendekut gjinor³ i Forumit ekonomik botëror, i cili vlerëson dallimet midis grave dhe burrave përmes kriterëve ekonomike, politike, arsimore dhe shëndetësore, ka rradhitur Republikën e Maqedonisë së Veriut në vendin e 73-të në vitin 2021 nga 156 vende, krahasuar me vendin e 70-të në vitin 2020 dhe vendin e 67-të në vitin 2017. Shteti ka pësuar rënie nga vendi i 28-të në vitin 2006, nga 58 shtete, në vendin e 53-të në vitin 2008 nga 130 shtete. Republika e Maqedonisë së Veriut është vlerësuar mjaft mirë në aspekt të përforcimit politik (53), për shkak të numrit të deputeteve femra në Parlament të arritur përmes kuotave, por me vlerësim të ulët në fushën e shëndetësisë dhe mbijetesës (85), pjesëmarrjes ekonomike dhe mundësive (97) dhe arritjeve arsimore (99).⁴

Duke qenë se perspektiva gjinore mundëson politika më të dedikuara, më të drejta dhe më efikase, Qeveria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë aspektit gjinor gjatë krijimit të politikave dhe miratimit të masave. Analiza e ndikimit të politikave na mundëson ta bëjmë aspektin gjinor pjesë përbërëse të procesit të krijimit të politikave. Në ndërkohë, mund të vlerësohen ndikimet e masave në të gjitha nëngrupet e grave (gratë me aftësi të kufizuara, gra të moshuara, nëna të vetme, gra nga komunitetet etnike joshumicë, gratë nga zonat rurale, etj.).

Që nga pavarësia e saj, Republika e Maqedonisë së Veriut është përpjekur të bëhet shtet anëtar i Bashkimit Evropian. Një nga parakushtet kryesore për anëtarësim është përmirësimi i kapacitetit demokratik, qeverisjes së mirë dhe reformat në shtetin e së drejtës. Reforma dhe modernizimi i sistemit të administratës publike është një proces i vazhdueshëm në vendet me demokraci të zhvilluar dhe ekonomi të tregut. Në këtë drejtim, vendimmarrja është veçanërisht e rëndësishme, kurse procesi i krijimit të politikave dhe ligjeve është edhe më i rëndësishëm. Për më tepër, vlerësimi i politikave rregullatore (si hartohen rregullativat dhe çfarë arrijnë ato) është një fokus i veçantë i shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD.

Në 15 vitet e fundit, Republika e Maqedonisë së Veriut ka ndërmarrë reforma serioze në sistemin e krijimit dhe zhvillimit të politikave që synojnë përmirësimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe

¹ Komisioni Evropian në raportin e progresit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021: https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/north-macedonia-report-2021_en.

² Covid 19 and gender 2020, available online http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2021/01/CRPM-Covid-19-%D0%B8-%D1%80%D0%BE%D0%B4%D0%BE%D1%82_prvo_ENG.pdf.

³ Global Gender Gap Report 2021, World Economic Forum, available online: https://www3.weforum.org/docs/WEF_GGGR_2021.pdf.

⁴ Po aty.

zbatueshmërisë. Shteti po zbaton reforma rregullatore që përfshijnë heqjen e vështirësive ligjore administrative përmes gjyotinjës rregullatore dhe futjes së disa mekanizmave për të zhvilluar politika/ligje të mençura, të tilla si vlerësimi i ndikimit rregullator dhe vlerësimi ex-post i ligjeve. Krijimi dhe koordinimi i politikave është një nga fushat prioritare të përcaktuara në Strategjinë për reforma në administratën publike (RAP) 2023-2030. Ministria për shoqëri informatike dhe administratë (MSHIA), nëpërmjet Sektorit për reformën rregullatore, koordinon procesin e vlerësimit të ndikimit rregullator (VNR) dhe kontrollon cilësinë e analizave të realizuara.

Çfarë është barazia gjinore?

Gratë dhe vajzat përfaqësojnë gjysmën e popullsisë së botës dhe për rrjedhojë gjysmën e potencialit të saj. Barazia gjinore, përveç se është një e drejtë themelore e njeriut, është thelbësore për arritjen e shoqërive paqësore, me potencial njerëzor të shfrytëzuar plotësisht dhe zhvillim të qëndrueshëm. Format e ndryshme të pabarazisë gjinore dhe të drejtave të pabarabarta bazohen kryesisht në stereotipet gjinore duke u caktuar role dhe përgjegjësi të ndryshme burrave dhe grave në bazë të paragjyqimeve (paragjykimi gjinor më së shumti favorizon burrat). Për këtë arsye, është veçanërisht e rëndësishme të ndërtohet vetëdijësimi gjinor dhe të kuptuarit e roleve të ndryshme të burrave dhe grave dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella në kontekstin e pushtetit, statusit, nevojave, etj. Nevojitet zhvillim i ndjeshmërisë të caktuar për të kuptuar si çështjet ashtu edhe domosdoshmërinë e zgjidhjes së tyre.

Në literaturë, nocioni “barazi gjinore” vendoset në raport me të drejtat e barabarta dhe është i orientuar drejt promovimit të pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të burrave dhe grave në shoqëri. Edhe pse barazia dhe të drejtat e barabarta ndonjëherë konsiderohen të njëjta, të drejtat e barabarta i referohen barazisë ligjore të burrave dhe grave (të drejta të barabarta) dhe për këtë arsye janë një parakusht për arritjen e barazisë: përfshirja e burrave dhe grave në të gjitha aspektet e jetës dhe shoqërisë. Barazia gjinore nuk është diçka që zhvillohet vetë; ajo është edhe kusht për zhvillim edhe parakusht për mirëqenien ekonomike e sociale. Përveç kësaj, zhvillimi social nxit transformimet, por, megjithatë, përvoja tregon se ndryshimet pozitive nuk janë automatike, përveç nëse disa çështje vendosen në kontekstin e mundësive të barabarta. Kjo çon në përfundimin se çështjet e barazisë gjinore nuk do të zgjidhen vetë.

Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se çështja e barazisë gjinore nuk është një problem që lidhet ekskluzivisht me gratë. Normat gjinore, stereotipet, paragjykimet, perceptimet lidhur me rolin e burrave në shoqëri janë pjesë përbërëse e fotografisë për barazi gjinore, respektivisht kanë pasoja të dëmshme si për burrat ashtu edhe për gratë. Ndarja e përgjegjësive familjare dhe shtëpiake dhe balancimi i jetës profesionale dhe familjare, u mundëson grave që të integrohen në tregun e punës dhe të përdorin burimet njerëzore në mënyrë më efektive.

Ndarja gjinore e punës dhe shpërndarja e resurseve, përgjegjësive dhe kompetencave përcaktohen nga rregulla dhe sisteme të ndryshme të vlerësimit sipas tregut apo shtetit. Duhet thënë se shumë aktivitete të kryera nga gratë ende nuk vlerësohen si pjesë e aktivitetit të përgjithshëm ekonomik. Puna e “padukshme” e grave në shtëpi, si dhe puna e papaguar dhe puna në sektorin informal janë vetëm një pjesë e shpjegimit të pozitës më të dobët ekonomike të gruas në drejtim të pavarësisë dhe mëvetësisë së tyre ekonomike. Hierarkia gjinore në kuadër të punësimit vendos më shumë

gra në aktivitete riprodhuese, punë të papaguar dhe punë informale ose më pak të paguara në sektorin formal.

Për shembull, vlerësohet se në Bashkimin Evropian gratë përbëjnë 80% të punëve të shtëpisë kur janë të punësuar dhe se ata shpenzojnë dy herë më shumë kohë duke u kujdesur për fëmijët sesa burrat.⁵ Duke mos përfshirë vlerën e punës shtëpiake në llogaritjen e prodhimit të brendshëm bruto (PBB), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) e ka vlerësuar atë në rreth 11 trilion dollarë amerikan në nivel global.⁶ Vlerësohet se në shumicën e vendeve vlera e punës së papaguar është e barabartë me rreth 50% të PBB-së. Ilustrime të tilla nuk janë vetëm një çështje e të drejtave, por edhe e efektivitetit të sistemit ekonomik në tërësi.

Parimet dhe rëndësia e arritjes së barazisë gjinore

Pse barazia gjinore është kaq e rëndësishme në sistemin e vendimmarrjes? Kjo është çështje e menaxhimit efikas të resurseve, ndërsa pjesëmarrja e grave në politikë është tregues i hapjes, karakterit demokratik dhe zhvillimit të institucioneve. Barazia gjinore konfirmon parimin e barazisë qytetare dhe padyshim që kontribuon në stabilitetin e shoqërisë në tërësi.

Fakti që shpërndarja optimale e punës, pronës dhe resurseve të tjera përcaktohet nga barazia gjinore, ilustron nga shmangia domethënëse që hasim kur shqyrtojmë marrëdhëniet e ndërsjella midis niveleve të zhvillimit dhe disproporcionit gjinor. Duhet të kemi parasysh se zhvillimi i mjedisit institucional dhe rrjedhat shoqërore përcaktohen kryesisht nga organizimi patriarkal i familjes, paragjykimet, stereotipet dhe perceptimet e ndryshme të roleve të burrit dhe gruas në shoqëri. Në shoqëritë e zhvilluara kjo mund të shërbejë si shpjegim për disproporcionin dhe pabarazinë e theksuar, nga njëra anë, dhe nivelin e zhvillimit, nga ana tjetër. Në shoqëritë e varfra, vazhdimësia e pabarazisë gjinore jep një kontribut të rëndësishëm në vazhdimësinë e varfërisë dhe ciklit vicioz të varfërisë.

Pabarazitë dhe dallimet, përfshirë ato të bazuara në seks, janë qendrore në teorinë sociale dhe politike të shtetit dhe demokracisë. Programet dhe politikat që bazohen në pabarazi, duke përjetësuar në këtë mënyrë pabarazitë, vënë në pikëpyetje besueshmërinë e parimeve bazë mbi të cilat mbështeten vendet moderne.

Duhet të merret parasysh fuqia dhe universaliteti i të drejtave të njeriut dhe parimi i barazisë gjinore si një nga parimet bazë të të drejtave të njeriut, i cili është në të njëjtën kohë baza e drejtësisë sociale dhe demokracisë. Ky parim përfshin pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e proceseve të politikave të barazisë dhe vë theks të veçantë rolin politik, ekonomik dhe social të grave, ndryshimi i pozicionit të të cilave do të bëjë çelësi për të kuptuar nevojat përkatëse sociale dhe ekonomike.

Pjesëmarrja aktive e grave në politikë, ekonomi dhe fusha të tjera të jetës është gjithashtu një parakusht për demokracinë, si dhe për barazinë dhe përparimin e shoqërisë në tërësi. Barazia

⁵ 2019 Eurostat, „How do women and men use their time – statistics“, https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=How_do_women_and_men_use_their_time_-_statistics&oldid=463738#Overview

⁶ ILO 2018, Care work and care jobs for the future of decent work. Geneva: ILO, https://www.ilo.org/global/publications/books/WCMS_633135/lang-en/index.htm#:~:text=This%20report%20takes%20a%20comprehensive,inextricably%20linked%20with%20care%20work

gjinore është gjithashtu një e drejtë e njeriut dhe një parim që duhet njohur, zbatuar dhe promovuar si i tillë. Kjo do të thotë se është e nevojshme të eliminohen format e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të pabarazisë si dhe të ndërtohet një mjedis ekonomik, politik, juridik dhe më i gjerë shoqëror me të drejta dhe mundësi të barabarta. Së bashku me pjesëmarrjen aktive, fokusi strategjik në forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore) është i një rëndësie të veçantë. Prandaj, promovimi i barazisë gjinore, edhe pse një të drejtë për të qenë ndryshe, imponohet si parim themelor i barazisë.

Barazia gjinore nënkupton mundësi të barabarta për të gjithë për të kontribuar në rritjen e mirëqenies sociale dhe të drejta të barabarta për të gjithë për të gëzuar përfitimet e mbrojtjes sociale. Barazia gjinore si e tillë bazohet në:

- ✓ të drejta të barabarta, qasje në drejtësi dhe barazi para ligjit;
- ✓ mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit seksual;
- ✓ të drejta të barabarta, mundësi dhe qasje në resurse;
- ✓ mundësi të barabarta në drejtim të pavarësisë ekonomike;
- ✓ pagë e barabartë për të njëjtën punë ose punë me të njëjtën vlerë;
- ✓ barazi në ndarjen e përgjegjësisë për familjen dhe ekonominë familjare;
- ✓ pjesëmarrje e barabartë në proceset vendimmarrëse;
- ✓ eliminim të stereotipeve dhe paragjykimeve gjinore të cilat shërbejnë si bazë për pabarazinë gjinore; dhe
- ✓ dinjitet, integritet dhe liri nga dhuna me bazë gjinore.

Në të njëjtën kohë, kjo nënkupton përgjegjësi të barabartë për heqjen e formave të tjera të pabarazisë që kontribuojnë në mosbalansim dhe cenueshmëri në shoqëri.

Çfarë është përfshirja e aspekteve gjinore në politikat kryesore ose ‘gender mainstreaming’?

Konceptualizimi i gjinisë buron nga pranimi fillestar i strategjisë së institucionalizimit gjinor në programet dhe organizatat zhvillimore (në nocionet: “përforcimi gjinor”, “fuqizimi”, “integrimi i grave në zhvillim” dhe “gratë dhe zhvillimi”). Integrimi i çështjeve gjinore në qëllimet e rritjes ekonomike, të drejtave të njeriut, zhvillimit njerëzor dhe mënyrës së trajtimit të tyre ka rezultuar në mungesën e efekteve përkatëse në barazinë gjinore. Politikat e barazisë që ishin karakteristike për vitet e shtatëdhjeta të shekullit XX u zëvendësuan me krijimin e trupave institucionale dhe një sistemi masash për avancimin e statusit të gruas. Programe dhe projekte të shumta ishin për “fuqizimin” e grave, por ato ishin më të fokusuara tek sipërmarrja sesa tek sfidat që lidhen me ekulibrin e pushtetit. Në një farë mënyre fokusi individualist korrespondonte me besimin në forcat e tregut dhe demokracinë liberale. Një qasje e tillë kontribuoi në getoizimin e grave me rezultate të përziera, por sigurisht që ishte e pasuksesshme në drejtim të arritjes së qëllimit kryesor, barazisë. Si rezultat, gjinia humbi fuqinë e saj analitike dhe u depolitizua.

Strategjia e qasjes “së re” - përfshirja e aspekteve gjinore në politikat kryesore - u përmend për herë të parë në vitin 1985, në Nairobi, në Konferencën e tretë të Kombeve të bashkuara për gratë, me rastin e diskutimit mbi rolin e grave në procesin e zhvillimit. Kjo nxiti zhvillimin e një strategjie që u prezantua në Konferencën e katërt pasuese botërore për gratë të mbajtur në Pekin në vitin 1995, e miratuar në formën e një platforme për veprim. Strategjia për përfshirjen e aspekteve gjinore në politikat kryesore u bë një ftesë për qeveritë dhe organizatat dhe institucionet ndërkombëtare që, “... të promovojnë një politikë aktive dhe të njohur në aspektin e përfshirjes të perspektivës gjinore në kuadër të politikave dhe programeve të tyre, duke analizuar efektin e tyre tek gratë dhe burrat përpara se të marrin ndonjë vendim.” (shih COE 2005 fq.7).

Sipas OKB ECOSOC, përfshirja e aspekteve gjinore në politikat kryesore ose ‘gender mainstreaming’ është “procesi i vlerësimit të implikimeve për gratë dhe burrat të çdo veprimi të planifikuar, përfshirë legjislacionin, politikat ose programet, në çdo fushë dhe në të gjitha nivelet.... Qëllimi përfundimtar i mejnstrimit është arritja e barazisë gjinore”.⁷ Në literaturën evropiane, më shpesh shfrytëzohet përkufizimi i M. Verlo, kryetar i grupit të ekspertëve të Këshillit të Evropës për përfshirjen e perspektivës gjinore, i cili në Raportin e tij në vitin 1998, tha se “përfshirja e perspektivës gjinore është (ri)organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve politike, në mënyrë që perspektiva për barazinë gjinore të përfshihet në të gjitha politikat në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat nga aktorët që zakonisht përfshihen në krijimin e politikave”.

Përfshirja e aspekteve gjinore në politikat kryesore shihet si një kornizë konceptuale, metodologji dhe prezantim i praktikës së mirë. Si i tillë, është një lloj “ribrendimi” i feminizmit në kohët moderne, duke përfshirë një perspektivë gjinore në zhvillimet kryesore shoqërore dhe në sistemet sociale, ekonomike, politike, kulturore, juridike me qëllim transformimin e strukturës shoqërore dhe institucionale drejtë barazisë gjinore. Vetë nocioni i barazisë bëhet pjesë e ideologjisë, strategjisë dhe politikës “të re”.

Sot, gati 20 vjet nga zbatimi i kësaj strategjie, e cila ishte baza e mijëra planeve, janë miratuar strategji dhe iniciativa të tjera. Prandaj, mund të përfundohet se integrimi i aspekteve gjinore në politikat kryesore është një projekt me fuqi të papritur dhe energji të jashtëzakonshme. Megjithatë, pavarësisht nga të gjitha sfidat qofshin ato politike, ekonomike, fetare, fundamentaliste, kriza ekonomike dhe masat për kursim, paragjykimet etj., ajo mbetet strategjia kryesore për arritjen e barazisë gjinore.

Sigurisht se ekziston nevoja për të konceptuar integrimin gjinor në kontekstin e pyetjeve të hapura, të cilat në pjesën më të madhe i referohen si në vijim:

- ✓ pozicionimit të barazisë gjinore dhe përfshirjes në politikat kryesore;
- ✓ mundësive alternative në procesin e transformimit të politikës për barazinë gjinore (modele për mundësi të barabarta ose trajtim të barabartë, “trilogji” e modeleve për trajtim të barabartë, perspektiva e grave dhe perspektiva gjinore);
- ✓ përfshirja gjinore në kontekstin e formave të tjera të pabarazive sociale;
- ✓ përfshirja e aspekteve gjinore në krijimin e politikave që mbështetet në ekspertizë ose në një proces më demokratik;
- ✓ implikime të një natyre ndërkombëtare që mund të lindin nga përfshirja e aspekteve gjinore në politikat kryesore.

⁷ UN ECOSOC, Gender mainstreaming <https://www.unwomen.org/en/how-we-work/un-system-coordination/gender-mainstreaming#:~:text=The%201997%20agreed%20conclusions%20of,areas%20and%20at%20all%20levels>.

Korniza ligjore për barazinë gjinore

Pse Qeveria duhet të përfshijë aspektin gjinor në krijimin e politikave? Republika e Maqedonisë së Veriut është përkushtuar të arrijë de jure dhe de facto barazinë gjinore dhe të sigurojë zhvillimin dhe avancimin e plotë të grave duke nënshkruar CEDAW⁸, Platformën e Pekinit të Kombeve të bashkuara për veprim (BPfA)⁹, Konventën e Stambollit¹⁰ dhe si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian në të cilin një nga vlerat themelore është barazia gjinore. Përveç kësaj, shtetet anëtare të Organizatës për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE), përfshirë Republikën e Maqedonisë së Veriut, shpallën përkushtimin e tyre për arritjen e barazisë gjinore në Kartën për siguri evropiane të vitit 1999, si dhe në Planin për veprim të OSBE-së për vitin 2004, për avancimin e barazisë gjinore. Edhe pse janë bërë përpjekje të konsiderueshme për avancimin e barazisë gjinore, pabarazitë gjinore në vend mbeten të shprehura në të gjitha sferat e jetës socio-ekonomike dhe politike.

Statusi i gruas në shoqërinë maqedonase është produkt i vlerave të rrënjësura socio-kulturore dhe riafirmohet me politika dhe norma. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk ka dispozita të përgjithshme për antidiskriminimin dhe nuk bën referencë specifike për barazinë gjinore, mundësitë e barabarta apo veprimet afirmative, megjithatë, ajo garanton të drejta dhe liri të barabarta, pavarësisht nga seksi, raca, ngjyra e lëkurës së tyre, prejardhja nacionale ose sociale, bindjet politike ose fetare, të qytetarëve dhe pozitës së tyre materiale e shoqërore (neni 9). Me dispozitat ligjore në mënyrë normative sigurohen mundësi të barabarta për femrat dhe meshkujt në vend. Zbatimi praktik i konceptit të krijimit të mundësive të barabarta filloi në vitin 1999, kur Republika e Maqedonisë së Veriut miratoi planin e parë nacional të veprimit për barazi gjinore. Në maj të vitit 2006, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Ligjin për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve, dhe në përputhje me të njëjtin, u miratua Plani i dytë nacional i veprimit për barazi gjinore për periudhën 2007-2012.

Ligji për mundësi të barabarta për femrat dhe meshkujt¹¹ (në tekstin e mëposhtëm: LMB) është miratuar për herë të parë në vitin 2006 dhe ka rregulluar masat themelore dhe të veçanta për vendosjen e mundësive të barabarta ndërmjet meshkujve dhe femrave në vend. Për të harmonizuar më tej legjislacionin tonë me standardet evropiane dhe për të inkuorporuar rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në vitin 2012, LMB u ndryshua duke zgjeruar listën e situatave në të cilat mund të paraqitetet diskriminimi, duke rregulluar bazën diskriminuese, si dhe futjen e reformave konceptuale.

Gender mainstreaming is defined as “integrating the gender perspective in each stage of the process of creating, adopting, implementing, monitoring and evaluating policies, having in mind promotion of gender equality between women and men.”

⁸ Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW), e miratuar në vitin 1979 nga Asambleja e përgjithshme e OKB-së, shpesh përkrahë si Ligj ndërkombëtar për të drejtat e grave i përbërë nga një preambullë dhe 30 nene, ajo përkufizon se çfarë përbën diskriminimi ndaj grave dhe përcakton një agjendë për veprimet nacionale për t'i dhënë fund një diskriminimi të tillë.

⁹ Deklarata e Pekinit dhe platforma për veprim (BPfA) është një deklaratë ndërkombëtare mbi të drejtat e grave, e përcaktuar në Konferencën e katërt botërore të OKB për gratë, e mbajtur në Pekin në 1995.

¹⁰ Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje u miratua nga Komiteti i ministrave të Këshillit të Evropës më 7 prill të vitit 2011.

¹¹ Ligji për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujt, i disponueshëm në internet në chrome-extension://efaidnbmnnpicajpcglclefndmkaj/https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2017/precisten%20tekst%202015%20na%20ZEM_nov.pdf

Article 4, Law on Equal Opportunities of Women and Men

Ligji rregullon gjithashtu masat themelore (nenet 5 dhe 6) dhe masat konkrete (neni 7) të cilat konsiderohen si masa të përkohshme për të tejkaluar situatën ekzistuese të pavolitshme të grave dhe burrave, e cila është rezultat i diskriminimit sistematik ose pabarazisë strukturore gjinore që rezulton nga rrethanat historike sociokulturore. Masat themelore për realizimin e parimit të mundësive të barabarta për femrat dhe meshkujt janë **masat normative** nga fusha e kujdesit shëndetësor dhe sigurimit shëndetësor, mbrojtjes sociale, qasjes në mallra dhe shërbime, ekonomisë, marrëdhënieve të punës dhe punësimit, arsimit dhe përsosjes profesionale, marrëdhënieve ekonomike dhe pronësore, përdorimit të produkteve dhe shërbimeve publike, (të drejtat e konsumatorit), kulturës dhe sportit, teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, mbrojtja, drejtësia dhe administrata, banimi, informimi publik dhe mediat, administrata shtetërore dhe publike, si dhe fushat tjera. Masat bazë përfshijnë edhe masat me të cilat futet përfshirja sistematike e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në procesin e krijimit, zbatimit dhe ndjekjes të politikave.

Subjektet të cilat janë përgjegjëse për miratimin dhe zbatimin e masave për vendosjen e mundësive të barabarta për femrat dhe meshkujt - LMB janë: Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, Ministria e punës dhe politikës sociale, Avokati i popullit, partitë politike etj. LMB obligon të gjitha institucionet që deri më 31 mars të vitit rrjedhës për vitin paraprak të dorëzojnë raport vjetor në Ministrinë e punës dhe politikës sociale (MPPS) për masat konkrete të ndërmarra për rritjen e barazisë gjinore (neni 8, fq. 4). Në këtë aspekt, ligji ndjek CEDAW. Në vitin 2018, në pajtim me LMB (neni 21), në kuadër të MPPS është emëruar përfaqësues ligjor për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve, obligim ligjor i të cilit është zbatimi i procedurave për përcaktimin e trajtimit të pabarabartë të femrave dhe meshkujve.

Gjithashtu, progres i dukshëm në promovimin e barazisë gjinore është bërë me miratimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, i cili paraqet një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për mbrojtjen nga diskriminimi sipas bazave të ndryshme. Ky ligj paraqiste një instrument veçanërisht të rëndësishëm në trajtimin e diskriminimit të dyfishtë dhe të shumëfishtë me të cilin përballen, veçanërisht, femrat si rezultat i interseksionit të gjinisë me identitete të tjera.¹² Në vitin 2020, me qëllim të sigurimit të mekanizmave, masave dhe aktiviteteve me të mira për mbrojtje ligjore nga diskriminimi, miratohet Ligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, i cili për herë të parë prezanton identitetin gjinor si bazë për diskriminim.¹³

Me ndryshimet në Ligjin për marrëdhëniet e punës¹⁴ janë futur dispozita që kontribuojnë drejtë fuqizimit ekonomik të grave dhe uljes të varfërisë dhe shkallës së lartë të papunësisë së popullatës femërore. Sipas tij, femrat dhe meshkujt kanë të drejta dhe mundësi të barabarta për të hyrë në tregun e punës dhe vendin e punës. Në Ligj është futur parimi i ndalimit të diskriminimit gjatë punësimit, ndalimi i diskriminimit të drejtëpërdrejtë dhe tërthortë në vendin e punës, ngacmimi

12 Neni 3 i Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi parasheh se: "Ndalohet çdo diskriminim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, thirrje dhe nxitje për diskriminim dhe ndihmë në veprim diskriminues në bazë të seksit, racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, përkatësisë në një grup të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, kombësisë, prejardhje sociale, religjionit ose besimit fetar, llojet tjera të besimeve, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal ose social, aftësisë të kufizuar mendore dhe fizike, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes pronësore, gjendjes shëndetësore ose çdo bazë tjetër e parashikuar me ligji ose një marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare (bazë diskriminuese).

13 Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, i disponueshëm online në chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.mtsp.gov.mk/content/%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%81%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%87%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5%20%D0%B8%20%D0%B7%D0%B0%D1%88%D1%82%D0%B8%D1%82%D0%B0%20%D0%BE%D0%B4%20%D0%B4%D0%B8%D1%81%D0%BA%D1%80%D0%B8%D0%BC%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0.pdf

14 Ligji për marrëdhëniet e punës, i disponueshëm online në https://mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%A0%D0%B0%D0%B1%D0%9E%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%81%D0%B8.pdf

dhe ngacmimi seksual. Ky ligj garanton të njëjtat kushte për përsosje dhe avancim profesional, si dhe rrogë të njëjtë për të njëjtën punë. Gjithashtu, Kodi zgjedhor si dhe Ligji për zgjedhjen e deputetëve dhe Ligji për zgjedhjet lokale parashikojnë masa të veçanta për përfaqësimin e të dy seksëve në listat e kandidatëve për deputetë dhe këshilltarë në vetëqeverisjen lokale.

Në nivel nacional, Republika e Maqedonisë së Veriut në mënyrë strategjike i qaset mundësimin të barazisë gjinore përmes një sërë masash të rëndësishme për zhvillimin e politikave, të shprehura më së shumti në Strategjinë për barazi gjinore 2013-2020¹⁵ (SBG) dhe planet nacionale të veprimit për barazinë gjinore. Si rezultat i zbatimit të planit nacional të veprimit 2018-2020, u parashikua avancimi i perspektivës gjinore në legjislacionin ligjor në përputhje me dispozitat e Ligjit për mundësi të barabarta për femrat dhe meshkujt, ligjet dhe politikat e avancuara me ndjeshmëri gjinore në procesin arsimor dhe harmonizimi i legjislacionit nacional me dispozitat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - Konventa e Stambollit.

Vendi ka bërë një përpjekje strategjike për të mbyllur hendeqet ekzistuese gjinore duke miratuar një politikë dhe kornizë ligjore që synon promovimin e barazisë gjinore. Edhe pse Strategjia nacionale për barazinë gjinore 2013-2020 nuk e ka arritur potencialin e saj të plotë për shkak të krizës me KOVID-19, megjithatë, Strategjia e re nacionale për barazinë gjinore 2022-2027 është miratuar dhe është dokumenti më gjithëpërfshirës strategjik i përgatitur me qëllim që të përmirësojë mundësitë e barabarta për burrat dhe gratë. Kjo strategji ndërlidhet me Planin nacional të veprimit për barazinë gjinore 2018-2022 dhe në këtë drejtim ofron një kornizë për vazhdimin e përpjekjeve të vendit drejt arritjes së barazisë gjinore. Tre mekanizmat kryesorë institucionale të Strategjisë janë: përfshirja e aspekteve gjinore në politikat kryesore, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor dhe ndërsektorialiteti. Me këtë dokument, rëndësia e barazisë gjinore është ngritur në një nivel të lartë sepse siguron perspektiva ndërsektoriale dhe horizontale për arritjen e prioritetëve universale shoqërore dhe politike.

Rregullativat¹⁶

Instrumentet për krijimin e politikave publike

Instrumentet për krijimin e politikave janë mjetet që u vihen në dispozicion qeverive për të zbatuar politikat me ndihmën e tyre. Pra, nuk është e nevojshme që qeveria të marrë vetëm një vendim për një çështje, por duhet edhe të ndërmarrë një sërë aktivitete për ta zbatuar atë vendim, në mënyrë që të mund të themi se qeveria ka politikë aktive në atë fushë. Instrumentet që i janë lënë në dispozicion çdo qeverie janë të shumta dhe klasifikimi i tyre është i vështirë. Nikolas Mur (Nikolas Baxter Moore) ka bërë një klasifikim shumë të thjeshtë të instrumenteve për krijimin e politikave i cili bazohet në elementin themelor – praninë e shtetit në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve të karakterit publik. Ai i ndan instrumentet për krijimin e politikave në dy grupe: vullnetare dhe të detyrueshme.

Instrumentet e detyrueshme janë mekanizma përmes të cilëve synohet të drejtohen individët, kompanitë ose grupet drejt aktiviteteve të caktuara. Nëpërmjet instrumenteve të detyrueshme, qeveria përdor fuqinë e saj të padiskutueshme për të detyruar qytetarët të ndërmarrin veprime të caktuara. Ajo mund të krijojë ndërmarrje publike për të ushtruar çdo funksion publik ose për

15 Strategjia për barazi gjinore 2013-2020 është e disponueshme online në http://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/strategjia_rodova_april.doc

16 Risteska M. (2017), "Politika publike, analiza e politikave publike dhe vlera publike", 1.4.2.1. Rregullativa, <https://fb.uklo.edu.mk/wp-content/uploads/sites/10/2021/10/PUBLIC-POLICY-ANALYSIS-OF-PUBLIC-POLICY-AND-PUBLIC-VALUE-Pdf.pdf>

të ofruar drejtpërdrejtë mallra dhe shërbime nëpërmjet aparatit të saj burokratik. Instrumente të tilla i lejojnë qeverisë të bëjë çfarë të dojë brenda autorizimeve të gjera kushtetuese dhe u lënë pak diskrecion individëve, grupeve, organizatave dhe firmave të synuara nga këto instrumente.

Numri më i madh i rregullivave janë, në fakt, vendime administrative që shërbejnë për të lehtësuar zbatimin e ligjeve nga organet e administratës ose agjencitë e specializuara qeveritare. Rregullivat shfaqen në forma të ndryshme dhe përfshijnë: rregulloret, standardet, lejet, ndalimet, vendimet dhe aktvendimet. Pas disa rregullativave ekziston detyrimi (policia dhe sistemi gjyqësor) për zbatimin e tyre. Ato ndryshojnë në natyrën e tyre dhe mund të jenë rregullativa ekonomike ose sociale. Rregullivat ekonomike kontrollojnë çmimet, vëllimin e prodhimit, kthimin e investimit dhe hyrjen dhe daljen e firmave nga një industri në tjetrën. Qëllimi i tyre është të korrigojnë pabarazitë që rezultojnë nga funksionimi i forcave të tregut.

Ndryshe nga rregullivat ekonomike, të cilat janë një formë tradicionale e instrumentit të detyrueshëm të krijimit të politikave publike, rregullivat sociale janë një formë më e re. Ata kontrollojnë çështjet që lidhen me shëndetin, sigurinë dhe praktikën sociale (për shembull, diskriminimi në punësim). Të gjitha rregullivat për sigurinë ushqimore, cilësinë e ujit, ajrit, mbrojtjen gjatë punës, nga ndotja, diskriminimin në bazë të seksit ose përkatësisë etnike, pornografisë, etj. janë shembuj tipikë të rregullativave sociale. Rregullivat për mbrojtjen e mjedisit jetësor janë një përzierje e rregullativave ekonomike dhe sociale, sepse problemet që zgjidhin janë të natyrës ekonomike, por kanë ndikim edhe në jetën sociale të qytetarëve.

Rregullivat kanë disa përparësi.¹⁷ Së pari, rregullivat janë shumë efikase dhe të parashikueshme, dhe për këtë arsye të pranueshme politikisht për ato politika ku publiku dëshiron të shohë një vendim të shpejtë dhe përfundimtar nga qeveria për një çështje të caktuar. Së dyti, në ato raste kur një aktivitet nuk dëshirohet aspak, siç është për shembull pedofilia, rregullivat mund të ndalojnë posedimin e materialit të pedofilisë, në krahasim me nxitjet që do të synonin të reduktonin prodhimin dhe shpërndarjen e atij materiali. Së treti, për të miratuar një rregullativë nuk është e nevojshme të dihen preferencat e subjekteve mbi të cilat do të zbatohet.

Rregullivat kanë gjithashtu mangësitë e tyre.¹⁸ Së pari, rregullivat shumë shpesh shtrembërojnë aktivitetet e sektorit privat dhe vullnetar dhe mund të çojnë në joefikasitet ekonomik. Së dyti, rregullivat që garantojnë sigurinë e tregut mund të kenë një efekt kufizues në zhvillimin dhe inovacionin teknologjik. Së treti, është e pamundur të miratohet rregullativë për çdo veprimtari apo aktivitet të padëshiruar, kështu që shpesh qeveritë lënë veprimtari të tëra, aktivitete të parregulluara që tregu apo komuniteti të kujdeset për ta.¹⁹ Së fundi, zbatimi i rregullativave ndonjëherë është i shtrenjtë.

Çfarë është vlerësimi i ndikimit të rregullator/të politikave?

Vlerësimi i ndikimit rregullator (në tekstin e mëposhtëm VNR) u konceptua fillimisht në Shtetet e

¹⁷ B.M. Mitnick, „The Political Economy of Regulation: Creating, designing, and removing regulatory forms“, Columbia University Press, 1980, p.401-404.

¹⁸ James Anderson, „Economic Regulatory Policies“, Lexington Books 1976.

¹⁹ Një shembull tipik janë shërbimet e kujdesit për të moshuarit në shtëpi të cilat deri vonë nuk ishin të rregulluara dhe ishte lënë që tregu (ofruesit e shërbimeve private si konviktet) të ofrojë shërbimin, ose komuniteti në bazë të solidaritetit ndërmjet generatave ku më të rinjtë kujdesen për më të moshuarit në familje.

Bashkuara të Amerikës, por ideja për VNR si pjesë e procesit të krijimit të politikave është përhapur me shpejtësi ndërkombëtarisht, e ndihmuar nga Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim Ekonomik (OECD) përmes raporteve të ndryshme, përfshirë Raportin e vitit 1997 mbi praktikën më të mira për VNR në vendet e OECD. Në Bashkimin Evropian, trupat e veçanta kanë siguruar që ideja e VNR të përhapet në shtetet anëtare. Një shembull i kësaj është grupi Mandelkern 155 - i cili përgatiti një raport për samitin e Lakenit të Këshillit Evropian dhe SIGMA, iniciativa e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian për reforma në administratën publike - i cili promovoi VNR si një mjet të rekomanduar nga Bashkimi Evropian për përmirësimin e cilësisë së politikave në vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe veçanërisht ato vende që aspirojnë anëtarësimin.

Siç pohon Klaudio Radaelli (2005), “VNR është shtylla kurrizore e procesit të krijimit të politikave sepse siguron standarde për të gjithë procesin, duke treguar se si të realizohen konsultimet publike, të llogariten dhe të parashikohen dhe shpenzimet socio-ekonomike nga miratimi i rregullativës dhe identifikon shmangiet kryesore të bëra me zgjidhjen e propozuar, e cila është marrë parasysh gjatë zhvillimit të legjislacionit, si dhe një analizë e ndikimeve të së njëjtës”. Në të gjitha kontekstet, vlerësimi i ndikimit përdoret përpara miratimit të rregullativës dhe synon të informojë vetë vendimin për miratimin e rregullivës. Megjithatë, modeli i VNR ndryshon në kontekste të ndryshme politike dhe përfshin procedura të ndryshme dhe përdor metoda të ndryshme të analizës në vlerësimin e ndikimit rregullator në vende të ndryshme në Evropë.

Rregullivat janë një nga instrumentet me të cilat krijohen politikat publike. Në kohë të globalizimit dhe zhvillimit të shpejtë teknologjik dhe social, rregullivat mund të vjetroheshin shpejtë. Prandaj, si instrument i krijimit të politikave publike, ato duhet t'i nënshtrohen vazhdimisht vlerësimit për të qënë në hap me botën që lëviz shpejtë dhe ndryshon.

Vlerësimi i ndikimit rregullator në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Modeli maqedonas i zhvillimit të politikave është i afërt me krijimin e politikave në mënyrë racionale-sinoptike, i cili është konceptuar në detaje nga Sabatier (1999). Ky model përfshin pesë faza:

- I. Përcaktimi i agjendës politike ose përkufizimi i problemit;
- II. Analiza e politikave ose identifikimi i opsioneve të politikave dhe vlerësimi i tyre;
- III. Miratimi i një opsioni të dhënë të politikës;
- IV. Zbatimi i opsionit të dhënë të politikës;
- V. Monitorimi dhe vlerësimi.

Në këtë drejtim, vlerësimi i politikave është një hap apo fazë më vete në procesin e krijimit të politikave, që pason pas zbatimit të politikës së re. Qëllimi i vlerësimit të politikave është të “identifikojë mësimet e nxjerra për të përmirësuar krijimin aktual të politikave dhe zbatimin e tyre” (OECD, 2012: 36).

Vlerësimi i ndikimit rregullator, nga njëra anë, ishte një reformë e inkurajuar nga Bashkimi Evropian, por nga ana tjetër, në aspekt të vlerësimit (evaluimit) ex-post, Republika e Maqedonisë së Veriut mori udhëheqjen dhe iu bashkua klubit të vendeve që kanë krijuar një kornizë për vlerësimin

rregullator edhe përpara se OECD të kishte zhvilluar kornizën e saj të treguesve për vlerësimin e politikave. Prandaj, përpjekjet për reforma rregullatore të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk janë risi, por janë gjithashtu një përpjekje pioniere për rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë.

Futja e VNR në vitin 2008 është rregulluar me ndryshimin e Rregullores të punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Rregullorja e punës parashikon që çdo ministri, bazuar në parimin e proporcionalitetit, është e detyruar të përcaktojë nëse teksti i propozim-ligjit do t'i nënshtrohet VNR-së përmes një vlerësimi paraprak nëse kërkohet një VNR e detajuar/gjithëpërfshirëse apo jo. Metodologjia për vlerësimin e ndikimit rregullator²⁰ e miratuar në vitin 2009, dhe e përmirësuar në vitin 2013 dhe 2017, parasheh se VNR duhet të përgatitet për propozim-ligjet që i dërgohen Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shqyrtim dhe përcaktim, me përjashtim të ligjeve miratimi i të cilave është propozuar me procedurë urgjente, ligjet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ligjet me të cilat bëhet harmonizimi terminologjik me ligjet tjera, propozim-buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ligji për realizimin e buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, VNR nuk është parashikuar për ligjet që propozohen nga anëtarët e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose nga iniciativat legislative civile të dorëzuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për më tepër, VNR nuk kërkohet të zbatohet për instrumente të tjera të krijimit të politikave të cilat nuk janë bërë pjesë e ligjit, për shembull, strategjitë, programet, informacionet dhe aktet nënligjore.

Metodologjia për vlerësimin e ndikimit rregullator përcakton harmonizimin e saj të plotë me procesin e planifikimit strategjik dhe krijimit të politikave, dhe zbatimin e VNR mbështetet nga sistemi informativ përmes seancës elektronike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe përmes Regjistratit të vetëm nacional elektronik të rregullave - (në tekstin e mëposhtëm: ENER, në shqip RVNE).²¹ Megjithatë, SIGMA vërtetoi se “deri më tani kjo teknologji nuk ka ndihmuar për t’iu përmbajtur procedurave të rëndësishme që mishërojnë vlerën e transparencës dhe llogaridhënies, siç është, për shembull, respektimi i periudhës minimale për konsultime” (SIGMA, 2014). Vlerësimi i ndikimit rregullator (VNR) është pjesë integrale e procesit të krijimit të politikave dhe koordinimit dhe përgatitjes së ligjeve. Pavarësisht se të gjitha fazat e procesit të zbatimit të VNR janë të përcaktuara formalisht dhe metodologjikisht, është evident mosrespektimi i procedurave të përcaktuara për VNR. Edhe pse në periudhën ndërmjet viteve 2014 dhe 2016 ka një trend të rritjes së numrit të propozim-ligjeve për të cilat është përgatitur VNR, megjithatë, nëse shohim individualisht sipas viteve, në rastin më të mirë, vetëm pak më shumë se gjysma (53.6%) e propozim-ligjeve u mbështetën me analiza.²²

Për sa i përket cilësisë së vlerësimit të ndikimit rregullator, analizat e Ministrisë të Shoqërisë Informatike dhe Administratës, të cilat i referohen përmbajtjes së raporteve për VNR, tregojnë se arsyetimet për propozimet ligjore, qëllimet, arsyet, opsionet dhe ndikimet e mundshme janë të përgjithshme dhe të përpunuara në mënyrë të pamjaftueshme, ndërsa të dhënat për ndikimet fiskale, ekonomike, sociale dhe për ndikimet tjera nuk ofrojnë informacion të mjaftueshëm për të marrë vendime të argumentuara. Përveç informacioneve të kufizuara të cilat ofrohen në raportet për VNR, vërehet edhe një derogim i rolit të MSHIA-së si ministri kompetente për kontrollin e cilësisë së procesit të VNR dhe përmbajtjes së analizave.²³

²⁰ Metodologjia e vlerësimit të ndikimit rregullator, e disponueshme online në https://www.mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/pvr/Metodologjia%20za%20PVR%20107-13.pdf

²¹ <https://ener.gov.mk/Default.aspx>.

²² Strategjia për reforma në administratën publike 2018-2022, e disponueshme online në https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/srja_2018-2022_20022018_mk.pdf

²³ Po aty.

Vlerësimi i ndikimit rregullator mbi barazinë gjinore

Cila është rëndësia e një vlerësimi të ndikimit rregullator të bërë nga perspektiva gjinore? Para së gjithash, kjo analizë bën të mundur prezantimin e perspektivës gjinore në fazën më të hershme të krijimit të politikave. Më pas, na lejon të shohim aspektin gjinor të problemit që duam të zgjidhim me krijimin e politikave. Na lejon të dizajnojmë edhe zgjidhjen e problemit për të përmbushur nevojat e ndryshme të burrave dhe grave, respektivisht, të jetë me përgjegjësi gjinore. Me VNR, ne përcaktojmë qëllimet dhe treguesit e politikës. Njohja e dimensionit gjinor të politikës na ndihmon që disa nga qëllimet t'i bëjmë me përgjegjësi gjinore dhe të masim arritjen e tyre me tregues gjinor. Dhe së fundi, me VNR nga perspektiva gjinore, ne parashikojmë ndikimin e pritshëm të politikës mbi (pa) barazinë gjinore dhe si do të ndihmojë në arritjen e angazhimeve të vendit për barazinë gjinore.

Vlerësimi i ndikimit rregullator mbi barazinë gjinore nënkupton zbatimin e një metodologjie të standardizuar për përkufizimin e opsioneve dhe zgjedhjen e opsionit më të mirë të politikës publike që do të çojë në zgjidhjen e problemit dhe avancimin e barazisë gjinore.

Procedura hap pas hapi është prezantuar kështu:

Hapi 1. Përkufizoni problemin - i cili, ndër të tjera, merr parasysh situatën aktuale midis burrave dhe grave në sektorin në të cilin po bëhet rregullativa.

Hapi 2. Përkufizoni qëllimet e politikave publike, duke përfshirë synimet që do të promovojnë barazinë gjinore.

Hapi 3. Identifikoni opsionet e politikave publike për arritjen e qëllimeve të politikave publike, duke përfshirë qëllimet për arritjen e barazisë gjinore.

Hapi 4. Analizoni ndikimet pozitive dhe negative, domethënë ndikimet direkte dhe indirekte të zgjidhjeve nga rregullativat e propozuara, vlerësimi i ndikimeve ekonomike dhe sociale dhe ndikimet në barazinë gjinore dhe ndikimet e tjera për secilin prej opsioneve.


Hapi 5. Përcaktoni mekanizmin për ndjekjen dhe vlerësimin duke përdorur treguesit gjinorë.

Hapi 1. Përkufizimi i problemit

Hapi i parë në përkufizimin e problemit është analizimi i situatës në zonën që i nënshtrohet rregullimit të mundshëm. Me analizën e situatave përcaktohen shkaqet, shtrirja, lloji, pasojat dhe prioritetet në zgjidhjen e problemeve në fushën që planifikohet të rregullohet me rregullativë. Gjatë vlerësimit të situatës, institucionet nacionale/lokale janë të detyruara të përfshijnë një analizë të situatës së grave dhe vajzave, burrave dhe djemve, si dhe nëngrupeve e tyre (për shembull, gratë rurale ose gratë që i përkasin një grupi pakicë ose gratë me aftësi të kufizuara) në një fushë specifike, duke identifikuar në ndërkohë, problemet, të cilat mund të jenë dallimet ekzistuese midis burrave dhe grave, si dhe shkaqet e problemit, përfshirë dallimet në nevojat e burrave dhe grave.

Në procesin e përgatitjes së rregullave, propozuesi mbledh informacione, punon në përpunimin dhe analizën e tyre dhe i klasifikon problemet e identifikuara në të ashtuquajturën “pema e problemeve” sipas vëllimit dhe përparësisë së problemit të specifikuar. Në mënyrë që pema të ketë një dimension gjinor, analiza e situatës përfshin konsideratat nëse, si dhe në çfarë mase, pozitivisht apo negativisht, situata në një fushë të caktuar ndikon në të drejtat, pozitën dhe cilësinë e jetës së grave dhe vajzave, burrave dhe djemve. Në këtë mënyrë do të mundësohet një kuptim i qartë i nevojave dhe problemeve që duhet të zgjidhen nga rregullorja për të garantuar barazinë gjinore. Si çdo pemë, pema e problemeve ka rrënjë, trung dhe degë. Arsyet janë rrënjët, problemi është trungu dhe degët janë pasojat e problemit.

Figura numër 1 - Pema e problemeve



Problemet e identifikuara janë dallimet gjinore, pasojat e pabarazisë gjinore (për shembull, nivelet e dhunës, hendeku gjinor në rroga ose qasja e pabarabartë në financa), dhe arsyet mund të jenë rolet gjinore, stereotipet gjinore, traditat, zakonet, bindjet dhe normat ose mungesa e rregullave për shkak të së cilave problemi nuk mund të zgjidhet me kornizën rregullatore ekzistuese.

Për të përkufizuar problemin, është e nevojshme të njihen nevojat e burrave dhe grave në fushën e hartimit të rregullave. Burrat dhe gratë kanë role të ndryshme në shoqëri dhe nevojat e tyre janë të ndryshme. Nevojat mund të kategorizohen në dy grupe: nevojat themelore dhe nevojat strategjike. Nevojat themelore lidhen me mbijetesën dhe përfshijnë nevojën për ushqim, strehim, veshje dhe ujë. Për shkak të lidhjes me kushtet materiale të jetës, nevojat bazë janë afatshkurtra dhe mund të arrihen me futjen e drejtpërdrejtë të materialeve. Megjithatë, përmirësimi i kushteve të jetesës nuk ndikon në statusin social që kanë gratë dhe burrat. Prandaj, kur përkufizojmë një problem, i kushtojmë vëmendje nevojave strategjike që gratë identifikojnë për shkak të “pozitës së tyre vartëse në raport me burrat në shoqëri”. Këto nevoja lidhen me fuqinë, kontrollin e resurseve dhe aftësinë për të marrë vendime.

Shumë faktorë ndikojnë në nevojat strategjike të grave: marginalizimi - përjashtimi nga proceset si vendimmarrja; diskriminimi - trajtim i ndryshëm i bazuar në faktorë mbi të cilët individit nuk ka kontroll, për shembull, gjinia, përkatësia etnike, kombësia, raca, etj.; objektivizimi - duke u dhënë grave më pak se statusi njerëzor dhe trajtim përulës i grave; infantilizimi - kategorizim i grave me fëmijë; tjetërsimi - përmes sistemeve patriarkale të trashëgimisë pronësore; vartësia - caktimi i një

pozicioni përulës për gratë, për shembull, trajtimi si qytetare të dorës së dytë; dhuna - keqtrajtimi fizik, mendor dhe emocional, i cili pranohet kulturalisht si “përmirësimi i gruas” ose praktika të dëmshme si gjymtimi i organeve gjenitale femërore për të nënshtruar dëshirën seksuale të një gruaje. Nuk është e lehtë të identifikohen nevojat strategjike të grave dhe ato lidhen me pozitën socio-ekonomike dhe politike të grave në krahasim me burrat. Nevojat strategjike mund të arrihen duke miratuar rregullativa për të mbështetur barazinë, duke identifikuar vlerat shoqërore që duhet të ndryshojnë dhe duke ndërtuar kapacitetet dhe aftësitë që gratë duhet të fitojnë për të arritur barazinë.

Hapi 2. Përkufizimi i qëllimeve

Hapi i dytë i vlerësimit të ndikimit rregullator i përkushtohet përkufizimit të qëllimeve të politikës publike për të cilat propozohet rregullativa. Qëllimi i politikës publike pasqyron gjendjen e dëshiruar në raport me problemet e përkufizuara. Nëse hapi i mëparshëm çon në identifikimin e problemeve që kanë dimension gjinor, atëherë edhe qëllimet duhet të jenë edhe gjinore. Nëse procesi i analizës së situatës çon në identifikimin e problemeve kryesore dhe specifike, atëherë përkufizohen qëllimet operacionale të përgjithshme dhe specifike. Duke pasur parasysh se numri i qëllimeve është zakonisht i kufizuar dhe prioritetet duhet të përcaktohen qartë, qëllimet e vendosura duhet të jenë në përputhje me strategjitë dhe politikat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Meqenëse barazia gjinore është një nga prioritetet në lidhje me integrimin evropian të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të paktën një nga qëllimet konkrete duhet të jetë qëllimi gjinor.

OECD rekomandon që qëllimet të jenë të qarta dhe konkrete, të matshme, reale, të pranueshme dhe të kufizuara në kohë, pasi kjo në fund të fundit kontribuon për një rregullativë më të mirë. Ato shërbejnë për të matur ndikimin e zbatimit të rregullave. Qëllimi gjinor është ai që ne dëshirojmë të arrijmë - një rezultat konkret brenda një afati kohor të caktuar.

Hapi 3. Identifikimi i opsioneve për politika publike

Pasi të identifikohen qëllimet e politikës publike dhe rregullat/vendimet, identifikohet zgjidhja e problemeve të identifikuara në hapin e parë. Opsionet e politikave publike janë një mënyrë e mundshme për të arritur qëllimin e përkufizuar në hapin e dytë. Opsionet paraqesin masa të ndryshme, zgjidhje për problemin e identifikuar dhe qëllimin e përkufizuar. Ka më shumë se një zgjidhje për çdo problem.

Së pari, duhet të identifikohen opsionet e duhura. Ajo që e bën të rëndësishme një opsion është lidhja e tij me shkaqet e problemit dhe qëllimet që synohet të arrijë. Propozuesi, gjithashtu shqyrton opsionin *status quo* - i cili shërben si një skenar themelor me të cilin krahasohen opsionet tjera. Ky opsion nënkupton ruajtjen e statusit aktual. Ka opsione që nënkuptojnë përmirësim të situatës aktuale ose të ashtuquajturat opsione inkrementale, si dhe opsione radikale që tentojnë të përmirësojnë rrënjësisht situatën.

Opsionet mund të jenë rregullatore ose jorregullatore, por propozuesi ka detyrimin të krijojë një listë të opsioneve të realizueshme. Për të përcaktuar opsionet e realizueshme, është e nevojshme të hidhni poshtë opsionet që nuk mund të realizohen për shkak të resurseve të kufizuara, parave, procedurave komplekse ligjore ose arsyeve të tjera. Nga këto opsione, më në fund identifikohen dy opsione dhe diskutohen në detaje për të zgjedhur dhe shpjeguar opsionin e preferuar dhe dimensionin e tij gjinor.

Zgjidhja e nevojave themelore	Zgjidhja e nevojave strategjike
<ul style="list-style-type: none"> ➤ Gratë duhet të përfshihen si përdoruese, dhe ndoshta edhe si pjesëmarrëse. ➤ Cilësia e jetës së grave mund të përmirësohet. ➤ Kryesisht, ajo nuk ndryshon rolet dhe marrëdhëniet tradicionale. 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Gratë si agjente të ndryshimeve, ose t'u mundësohet grave të bëhen agjente të ndryshimeve ➤ Përmirësimi i pozitës së gruas në shoqëri. ➤ Fuqizimi i grave dhe transformimi i marrëdhënieve midis burrave dhe grave.

Për t'i dhënë një dimension gjinor opsioneve, duhet gjetur një zgjidhje për nevojat që kanë gratë dhe ato janë të ndryshme nga nevojat e burrave. Në hapin e parë përkufizohen nevojat themelore dhe strategjike. Opsionet për zgjidhjen e nevojave praktike përfshijnë gratë si përfituese dhe ndoshta si pjesëmarrëse në masat rregullatore. Këto masa mund të përmirësojnë cilësinë e jetës, por nuk ndikojnë në statusin social apo nuk transformojnë rolet gjinore dhe marrëdhëniet gjinore midis burrave dhe grave. Opsionet të cilat u referohen nevojave strategjike përfshijnë gratë si agjente të ndryshimit ose aftësimin e grave që të bëhen agjente të ndryshimit. Këto masa veprojnë në përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe përfshijnë masa për fuqizimin e grave, të cilat në mënyrë të tërthortë çojnë në transformimin e marrëdhënieve midis burrave dhe grave.

Hapi 4. Vlerësimi i ndikimit dhe përzgjedhja e opsionit më të mirë

Ky hap ndihmon për të shqyrtuar në detaje dy opsionet e përzgjedhura, për të vlerësuar ndikimin e tyre, si dhe për të shpjeguar opsionin e preferuar dhe dimensionin e tij gjinor kur propozohet një rregullativë ose vendim. Ky vlerësim shpjegon ndikimet pozitive dhe negative ose të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta të zgjidhjeve të rregullativave të propozuara në ekonomi, shoqëri dhe barazi gjinore.

Vlerësimi i ndikimit ekonomik - Në bazë të analizës së ndikimeve ekonomike, shqyrtohet se si propozimi i rregullativave apo vendimeve ndikon në konkurrencën, degët e caktuara të ekonomisë dhe subjektet ekonomike, konsumin dhe konkurrencën e ekonomisë, punën dhe produktivitetin dhe zhvillimin teknologjik dhe inovativ. Analiza ekonomike përfshin shpenzimet dhe përfitimet e opsioneve të politikave publike të disponueshme për ekonominë, dhe në veçanti për subjektet ekonomike individuale. **Futja e një perspektive gjinore në analizën ekonomike nënkupton marrjen parasysh të situatës së bizneseve të grave (bizneset në pronësi ose të udhëhequra nga gratë); si ndikojnë masat në konkurrencën dhe produktivitetin e tyre në treg dhe nëse masat e propozuara inkurajojnë veçanërisht gratë sipërmarrëse për të investuar në inovacion dhe zhvillim teknologjik; krijim të vendeve të punës etj.**

Vlerësimi i ndikimit social - Në bazë të analizave të ndikimeve sociale, shqyrtohet se si rregullativa apo vendimi i propozuar prek grupet e ndryshme të shoqërisë (individët dhe grupet), veçanërisht ata që janë në një situatë të vështirë dhe specifike sociale ose gjendja e të cilëve mund të përkeqësohet me miratimin dhe zbatimin e rregullativës. Grupet e përfshira janë shpesh grupe të rrezikuara dhe të marginalizuara (prindër të vetëm, persona të moshuar, të papunë, banorë në zona rurale me të ardhura të ulëta, persona me aftësi të kufizuara, etj.). Bashkimi Evropian ka dhënë udhëzime që duhet të merren parasysh kur vlerësohen ndikimet sociale, përkatësisht ndikimi i rregullativave mbi:

- ✓ punësimin dhe tregun e punës;
- ✓ standardet dhe të drejtat lidhur me cilësinë e punës;
- ✓ përfshirjen sociale;

- ✓ barazinë dhe mosdiskriminimin;
- ✓ sistemin e mbrojtjes sociale, sistemin e kujdesit shëndetësor dhe sistemin arsimor.

Futja e perspektivës gjinore në analizën e ndikimit social do të thotë se rregullativa ndikon te burrat dhe gratë në mënyra të ndryshme si individë dhe në grupe që i nënshtrohen shqyrtimit të detajuar, sepse gratë nga grupe specifike janë pjesa më e rrezikuar e popullsisë. Kështu, analiza gjinore fokusohet në ndikimin që ka rregullativa tek nënat e vetme, gratë e papuna, gratë rurale, gratë me aftësi të kufizuara etj.

Vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor - Opsionet të cilat realizohen në bujqësi, energji dhe transport kanë një ndikim të rëndësishëm në mjedisin jetësor, për shembull: ndërtimi i inovacioneve, parqeve teknologjike dhe industriale, zgjerimi i tokës bujqësore, ndërtimi i hekurudhave etj. **Në analizën e ndikimit mbi mjedisin jetësor, futja e një perspektive gjinore nënkupton vlerësimin nëse rregullativa rrit numrin e grave të varfra që nuk mund të paguajnë faturat e tyre të energjisë elektrike, ose nëse numri i grave të varfra zvogëlohet sepse transporti publik më i lirë është në dispozicion me investime në infrastrukturën e re të transportit.**

Vlerësimi i ndikimit mbi barazinë gjinore - Analiza e ndikimit mbi barazinë gjinore kërkon që të gjitha të dhënat në dispozicion të institucioneve të ndahen sipas seksit. Më pas këto të dhëna analizohen duke krahasuar burrat dhe gratë dhe duke përcaktuar dallimet midis tyre. **Dallimet janë pabarazi gjinore që propozuesi duhet të analizojë, pavarësisht nëse masa që ai propozon ka ndikim në uljen apo rritjen e tyre. Në këtë mënyrë identifikohet se si rregullativa ndikon në marrëdhëniet gjinore midis burrave dhe grave dhe barazinë gjinore.**

Hapi 4.1. Konsultimet

Pasi të miratohet vlerësimi i ndikimit, projekt-rregullativa ose vendimi, konsultohen të gjitha palët e përfshira. Konsultimi përfshin mbledhjen e informacioneve, mendimeve dhe propozimeve nga aktorë të ndryshëm. Në të njëjtën mënyrë merren informacione shtesë dhe qartësohen çështjet me rëndësi për miratimin e vendimit për dekretin (vendimin) në komisionin e formuar më parë dhe/ose këshillin e komunës. Publiku i interesuar përfshin qytetarët, organizatat e shoqërisë civile (sindikatat, punëdhënësit, shoqatat, grupet civile joformale, organizatat civile dhe komunitetet fetare), përfaqësues të komunitetit akademik, dhomat ekonomike ose persona që mund të ndikohen nga rregullativat ose personat që do të përfshihen në zbatimin e tyre.

Aspektet kryesore kur barazia gjinore integrohet në konsultime:

- ✓ A e mori parasysh konsultimi përfshirjen e barabartë të burrave dhe grave; a u organizuan seanca dëgjimore kur gratë ishin të lira, si u transmetuan informacionet nga seanca, nëse informacioni ishte i disponueshëm në vendet ku qarkullonin gratë (kopshte, shkolla, etj.)
- ✓ A evidentoi procesi i konsultimit dallime në përvojë, perceptim dhe nevoja midis burrave dhe grave, a kanë ata një pozicion dhe rol specifik në shoqëri?
- ✓ A janë të përfshira organizatat e shoqërisë civile në procesin e konsultimeve dhe debateve publike që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave dhe barazinë gjinore?
- ✓ A përfshihen në konsultim dhe debat publik mekanizmat që punojnë në fushën e barazisë gjinore, për shembull, nëpunësit shtetëror të ngarkuar për futjen e barazisë gjinore në politikat në nivel lokal dhe a pranohet dhe integrohet në rregullore mendimi i tyre si ekspert? Cilat janë rekomandimet e tyre?

Hapi 4.2 Implikimet fiskale

Kjo analizë përfshin një vlerësim të resurseve financiare të nevojshme për zbatimin e rregullativës/ vendimit dhe burimeve të mundshme nga të cilat sigurohen këto resurse, si dhe një vlerësim të ndikimit të zbatimit të rregullave/vendimeve mbi buxhetin komunal dhe/ose qëndror. Kjo do të thotë se vlerësimi i implikimeve fiskale përfshin një vlerësim të efekteve mbi të ardhurat publike dhe shpenzimet publike. Analiza e implikimeve fiskale nga perspektiva gjinore e ndjek situatën nëse gratë janë burim i financimit të rregullativave, dhe nga ana e shpenzimeve ndjek se si shpërndahen shpenzimet dhe nëse gratë dhe burrat përfitojnë në mënyrë të barabartë prej tyre.

Hapi 4.3. Zgjedhja e opsionit më të mirë

Në bazë të vlerësimit të ndikimit, konsultimeve dhe pas analizës së ndikimeve fiskale, propozohet opsioni më i mirë, i cili propozohet si opsioni i preferuar për t'u miratuar. Në këtë kuptim, vlerësimi për zgjedhjen e opsionit më të mirë bazohet në kriteret e mëposhtme për zgjedhjen e opsionit më të mirë për politikën publike: efektiviteti, efikasiteti, realizueshmëria politike, financiare dhe administrative, shpërndarja e shpenzimeve, barazia dhe qëndrueshmëria.

Fillimisht bëhet një listë opsionesh dhe më pas rekomandohet të formohet matrica e suksesit në të cilën për secilin kriter futen vlerësimet - pikët, analizat e anëve pozitive dhe mangësitë. Më pas, ndër opsionet e shqyrtuara në detaje, zgjidhet opsioni që ofron mënyrën më të mirë për të arritur ndryshime dhe për të arritur qëllimet e përcaktuara. Kjo analizë e ndihmon propozuesin të shpjegojë pse ky opsion u zgjodh dhe u propozua për miratim.

Hapi 5. Monitorimi dhe vlerësimi

Monitorimi është një proces i mbledhjes sistematike të të dhënave për zhvillimin, zbatimin dhe arritjen e qëllimeve dhe/ose rregullativave të politikës publike që realizohet gjatë zbatimit në intervale të caktuara kohore. Monitorimi bëhet në bazë të treguesve të paracaktuar që mund të krahasohen me gjendjen fillestare.

Vlerësimi është një proces i pavarur. Përmes vlerësimit bëhet një analizë e përfitimit, rezultateve, ndikimit, qëndrueshmërisë dhe rëndësisë së një politike apo rregullative të caktuar publike lidhur me qëllimet e vendosura. Vlerësimi shërben për të parë nëse rregullativa arrin qëllimin e dëshiruar dhe për të informuar procesin e vendimmarrjes, nëse ka nevojë për futjen e masave të reja apo të ndryshme të politikave publike, si dhe ndryshime në rregullativë apo miratimin e rregullave të reja.

Kur bëhet vlerësim nga perspektiva gjinore, është e nevojshme të gjejmë përgjigje për këto pyetje:

- ✓ Çfarë ndryshimi është arritur dhe çfarë efektsh ka ky ndryshim në pozitën e grave dhe burrave në rastin konkret?
- ✓ Cilat zgjidhje kanë rezultuar të suksesshme në promovimin e barazisë gjinore dhe pse?
- ✓ Çfarë mund të ishte bërë ndryshe?

Integrimi i perspektivës gjinore në monitorim dhe vlerësim siguron që rezultatet e zbatimit të kenë ndikim në pozitën e grave dhe burrave, si dhe një ndikim të përgjithshëm në avancimin e barazisë gjinore.

Treguesi mat qëllimin që duhet arritur, efektin e resursit të mobilizuar, parametrin e prodhimit të arritur, efektin e marrë ose ndryshimet në kontekst - ekonomik dhe social, ose në mjedisin jetësor. Për të qenë në gjendje të ndjek qëllimet gjinore, propozuesit duhet të propozojnë dhe tregues gjinorë për rregullativën që propozon për miratim. Treguesit gjinorë masin ndryshimet gjinore (transformimet në rolet gjinore, barazia në marrëdhëniet gjinore, pjesëmarrja e grave

në ekonomi, jetën publike, politikë, etj., si dhe ndryshimet në ndikimin e gruas në tendencat sociale, ekonomike dhe politike) në nivel qëndror dhe nga momenti kur zbatohet rregullativa/ vendimi. Treguesit gjinorë mund të jenë themelore kur tregojnë gjendjen fillestare dhe treguesit e rezultatit/efektit kur tregojnë se ku duam të jemi.

Kur të përfundojë vlerësimi dhe analiza e ndikimit të rregullave ose vendimeve, përgatitet një raport i vlerësimit të ndikimit rregullave.

Përpara përgatitjes së një raporti të vlerësimit të ndikimit mbi perspektivën gjinore për një rregullativë/vendim të propozuar, është e nevojshme të kontrolloni nëse udhëzimet janë ndjekur duke përdorur formularin e kontrollit më poshtë.

Doracak për vlerësimin e ndikimit rregullator mbi barazinë gjinore

Parakushtet
A është përshtatur përbërja e grupit të punës me parimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave, sa më shumë që të jetë e mundur? <input type="checkbox"/>
A përfshihen persona me ekspertizë të duhur në fushën e barazisë gjinore në fazën e përkufizimit të problemit? <input type="checkbox"/>
A është marrë në konsideratë dhe a ka tashmë strategji, politika publike dhe analiza që tregojnë problemin nga këndvështrimi i barazisë gjinore në këtë fushë? <input type="checkbox"/>
A keni të dhëna të ndara sipas gjinisë? <input type="checkbox"/>
A përfshijnë këto të dhëna edhe të dhëna për moshën, përfaqësimin territorial dhe treguesit socio-ekonomikë? <input type="checkbox"/>
A paraqiten të dhënat në mënyrë sasiore dhe cilësore? <input type="checkbox"/>
A përfshihen pyetjet që lidhen me aspektin gjinor të analizës në listën e pyetjeve dhe informacioneve të nevojshme shtesë? <input type="checkbox"/>
A janë identifikuar subjektet që mund të japin përgjigje për këto pyetje?; A ndahen treguesit statistikor sipas gjinisë? <input type="checkbox"/>
A sigurohet përfshirja e mekanizmave gjinorë, i grave dhe burrave kryesorë (si përdorues ose palë të interesuara), organizatave të shoqërisë civile që merren me të drejtat e grave ose barazinë gjinore në procesin e konsultimit? <input type="checkbox"/>

Hapi 1.

A i referohet fusha e rregullimit grupeve të caktuara të shoqërisë dhe cilave? Kujt i referohet rregullativa? <input type="checkbox"/>
Cilat janë nevojat e grave dhe burrave në terren dhe a ka dallime në pozicionin e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve apo grupeve të ndryshme shoqërore të të njëjtës gjini? Cili është dallimi dhe cili është vëllimi i tij? <input type="checkbox"/>
Sa ndikojnë këto dallime në jetën e përditshme, të drejtat, statusin dhe rolin e grave dhe burrave, apo vajzave dhe djemve? <input type="checkbox"/>
Cilat janë shkaqet dhe pasojat e kësaj situatë mbi barazinë gjinore? A ka diskriminim? <input type="checkbox"/>
A janë përkufizuar prioritetet ndërmjet çështjeve që lidhen me barazinë gjinore? <input type="checkbox"/>
A janë paraqitur treguesit kuantitativ dhe kualitativ lidhur me këto probleme? <input type="checkbox"/>
A ndikojnë dhe në çfarë mase ndikojnë politikën publike që zbatohen aktualisht në zgjidhjen e plotë apo të pjesërishtme të problemeve të identifikuar? <input type="checkbox"/>

A janë integruar problemet e identifikuar që lidhen me barazinë gjinore në të ashtuquajturën pemë të problemeve në një fushë të caktuar?

A i referohet fusha e rregullimit grupeve të caktuara të shoqërisë dhe cilave? Kujt i referohet rregullativa?

Hapi 2.

Cila është situata e dëshiruar për sa i përket problemit kryesor të identifikuar dhe problemeve specifike në fushën e trajtuar nga rregullativa?

A është identifikuar se çfarë ndryshimi pritet në shoqëri, duke pasur parasysh nevojat specifike të burrave dhe grave?

Nëse problemi (et) pasqyrojnë pabarazinë gjinore në mundësi, pozicione ose të drejta, a kontribuojnë qëllimet e përkufizuara në reduktimin ose eliminimin e atij diskriminimi të pabarazisë?

A kontribuojnë qëllimet e përkufizuara në arritjen e qëllimeve strategjike për promovimin e barazisë gjinore?

Hapi 3.

A janë përkufizuar opsione specifike për zgjidhjen e problemit dhe arritjen e qëllimeve?

A është përdorur gjuha e ndjeshme ndaj gjinisë në formulimin e opsioneve?

Është vlerësuar se cilat informacione/të dhëna statistikore për gratë dhe burrat duhet të përdoren për të vlerësuar ndikimin e opsioneve alternative nga perspektiva gjinore. A është i disponueshëm ky informacion dhe a është e nevojshme të mblidhen informacione shtesë?

A është përcaktuar nëse mekanizmat gjinorë, institucionet apo organizatat, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, se kanë informacionin e nevojshëm shtesë? A është vlerësuar nevoja për përfshirje profesionale të mekanizmave gjinorë apo organizatave të shoqërisë civile në vlerësimin e ndikimit të opsioneve?

Hapi 4.

Vlerësimi ekonomik:

A është përcaktuar se si efektet ekonomike ndikojnë në pozitën e grave dhe burrave?

A është më i fortë apo më i dobët përfaqësimi dhe ndikimi i tyre në mjedisin afarist etj.?

Mbrojtja e mjedisit jetësor

A është përcaktuar se si ndikimi mbi mjedisin jetësor (klime, përdorimi i tokës, mbrojtja e sigurisë të ushqimeve, etj.) ndikon në jetën e grave dhe burrave?

Vlerësimi social:

A është ndikimi i opsioneve të propozuara pozitiv apo negativ në grupe të caktuara shoqërore, veçanërisht tek gratë dhe grupet e marginalizuara/të rrezikuara në shoqëri?

A e përforcon opsioni specifik rolin dhe pozitën e gruas?

Vlerësimi i barazisë gjinore:

A është përcaktuar se si secili prej opsioneve të propozuara të politikave publike do të ndikojë në barazinë gjinore?

Vlerësimi fiskal:

A imponojnë rregullat përfitime apo shpenzime të caktuara për qytetarët? Si ndikon kjo tek gratë? Deri në çfarë shkalle shpenzimet për zbatimin e rregullave do të bien më shumë mbi gratë sesa burrat?

A ekziston një shpërndarje proporcionale e mjeteve nga buxheti publik për gratë dhe burrat?

A është identifikuar se cili opsion, së bashku me një vlerësim të ndikimit, do të kontribuojë më së miri në arritjen e qëllimeve strategjike për avancimin e barazisë gjinore?

Hapi 5.

A përfshin lista e të dhënave që do të mblidhen, të dhëna mbi përfaqësimin dhe ndikimin e rregullativave mbi gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat (aty ku është relevante)?

A është e mundur të maten ndryshimet në pozicionin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave (pozitive apo negative)?

A mund të matet se si këto ndryshime ndikojnë në arritjen e qëllimeve identifikuar të politikave publike/rregullatore?